



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 43/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Nenad Lazić dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Robertina Lekaj, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Gazmend Muhaxheri, kryetar i degës së LDK-së, në Pejë, kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), lidhur me ndërrimin e kryesuesit dhe anëtarëve të Këshillit të Vendvotimeve, në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 06.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet si i palejuar apeli i Gazmend Muhaxheri, kryetar i degës së LDK-së, në Pejë.

A r s y e t i m

Me datën 03.06.2017, PZAP-i ka pranuar një apel nga Gazmend Muhaxheri, kryetar i degës së LDK-së, në Pejë, në të cilin propozon që të anulohet lisat e përpiluar nga ana e KKZ-së, në Pejë, të ndryshohet dhe komisionerët të vendosen në vendvotime duke u bazuar në listën e dorëzuar nga dega e LDK-së, në Pejë.

Parashtruesi i apelit si provë ka bashkëngjitur kopjen e listës së dorëzuar nga dega e LDK-së, në Pejë dhe kopjen e listës së përpiluar nga KKZ-ja.

PZAP-i, pas pranimit të apelit në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoj KQZ-në me datën 04.06.2017, për apelin që është bërë.

PZAP-i pranoi përgjigjen e kërkuar nga KQZ-ja brenda afatit të caktuar, në të cilën theksohet se në mbledhjen e mbajtur me datë 31.05.2017, nr. 827/2017, KKZ-ja ka miratuar përbërjen e kryesuesve, anëtarëve dhe anëtarëve rezervë të Këshillave të Vendvotimeve për Komunën e Pejës. Po ashtu theksohet se kryesuesi i KKZ-së në Pejë, ka njoftuar përmes email-it personin kontaktues të koalicionit LDK-AKR-AL që ti përmbahet formulës për KVV-të, e cila formulë-përbërje iu është dërguar nga KKZ-ja e Pejës subjekteve politike dhe se të njëjtit nuk ju kanë përmbajtur ndarjes së vendeve sipas formulës e cila iu është dërguar subjekteve po ashtu kanë bërë ndryshime dhe plotësime në listën e dorëzuar në KKZ dhe më pastaj lista finale është dorëzuar nga KKZ-ja në KQZ për miratim.

Si provë në përgjigje kanë bashkëngjitur email-et e dërguara nga kryesuesi i KKZ-së në Pejë dhe listën e kryesuesve, anëtarëve dhe anëtarëve rezervë të Këshillave të Vendvotimeve.

PZAP-i gjeti se apeli është i palejuar:

Parashtruesi i apelit Gazmend Muhaxheri, kryetar i degës së LDK-së, në Pejë, pretendon se në mënyrë jo të drejtë dhe jo ligjore është bërë ndërrimi i vendeve të anëtarëve dhe kryesuesve të KVV-ve, nga ana e KKZ-së dhe KQZ-së në Pejë.

Paneli, vlerëson se apeli i parashtruar është i palejuar ngase PZAP, vendos sipas nenit 122 të LZP-së, vetëm ndaj vendimeve të KQZ-së, e jo ndaj vendimeve të KKZ-ve ashtu si ankuesi ka parashtruar në apel me të cilat pretendime e kundërshton vendimin e ndërrimit emra të KVV-ve në listë nga ana e KKZ-së në Pejë.

Andaj, PZAP-i në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 43/2017 më datën 06.06.2017.



**Kryesuesi i Panelit
Fejzullah Rexhepi**

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në *Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.*